

ALBULENA PLLANA BREZNICA
FISNIKE G. PLLANA

**VËSHTRIM RRETH PËRDORIMIT TË ANGLICIZMAVE
TEK NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA
NË VUSHTRI**

Në punim janë prezantuar rezultatet e hulumtimit të përdorimit të anglicizmave në jetën e përditshme të komunikimit tek nxënësit e tri shkollave të mesme të larta në Vushtrri. Hulumtimi është realizuar në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” me 52 nxënës, në shkollën e mesme profesionale “Bahri Haxha” me 48 nxënës dhe në gjimnazin “Eqrem Çabej” me 64 nxënës, me klasat e dymbëdhjeta.

Në bazë të hulumtimeve janë fituar rezultatet përfundimtare, në formë grafike, ku lista e përdorimit të anglicizmave ka qenë maksimalisht 18 fjalë nga fjalori i përditshëm i nxënësve. Nxënësit e gjimnazit kanë shënuar më shumë fjalë angleze të zakonshme krahasuar me ata të shkollave të mesme teknike-profesionale. Nxënësit e shkollave profesionale përdorin më tepër anglicizma përterma teknikë e nga fusha e informatikës, kurse të gjimnazit përdorin më tepër anglicizma nga fjalët e zakonshme.

Fjalët çelës: *anglicizmat, shkollat e mesme të larta, globalizimi, informatika, huazimet.*

Hyrje

Komunikimi në mes njerëzve është aq i vjetër sa dhe gjinia njerëzore. Duke u nisur nga e vërteta, njerëzimi ka pasur kontakte në mes të fqinjëve me gjuhë të ndryshme. Njohuritë e njerëzve janë shtuar intensivisht edhe me zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës. Përdorimi i anglicizmave tek nxënësit e shkollave të mesme në Vushtrri me anë të huazimit të anglicizmave është relativisht i madh. Gjuha shqipe në kontakt me gjuhët e fqinjëve ka huazuar fjalë të ndryshme, kurse pas vitit 1999 me ardhjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë është shtuar dukshëm numri i përdorimit të anglicizmave. Një formë e studimit të përdorimit të anglicizmave tek nxënësit paraqet edhe ky punim. Mirëpo, mund të themi

se ky është hapi i parë në këtë drejtim për këtë dukuri tek nxënësit e shkollave të mesme të Vushtrisë. Kjo gjë shqetëson dhe irriton me të madhe jo vetëm profesorët dhe dashamirët e gjuhës shqipe, por edhe lexuesit dhe dëgjuesit e fjalës shqipe. Shumica e fjalëve angleze, të panevojshme, hyjnë në gjuhën tonë prej gjuhës së shkrimit kryesisht nga përkthimet e teksteve për gazeta, media, televizione etj. Kjo ndodh për shkak të mungesës së kujdesit të mjaftueshëm nga ana e përkthyesve të materialeve që përkthehen prej gjuhës angleze në gjuhën shqipe. Pjesëmarrës të kësaj shëmtie janë edhe disa gazetarë, lektorë gjuhësorë, mësimmindhënës, redaktorë të teksteve e përgjegjës të institucioneve të informimit masiv në gjuhën shqipe¹.

Vrullimi i gjuhës angleze

Gjuha angleze, është kaluar nga gjendja ku gjuha botërore ishte thjesht mundësi teorike, në atë të shndërrimit të saj të vrullshëm në realitet. Andaj, asnjë qeveri ende nuk ka arritur të dalë me një politikë mbrojtëse gjuhësore të sendërtueshme ose të besueshme. Lidhjet me gjuhën globale në lindje e sipër, pra, me anglishten, e cila perceptohet si gjuhë e mundësive, duhet të garantohen. Ndërkohë, duhet të merren vendime tejet jetike për përparësitë. Megjithatë, të çudit fakti se kjo po ndodh me anglishten, e cila mbetet ndër gjuhët që ka marrë më së shumti fjalë nga gjuhët e tjera. Kështu, nga analiza kompjuterike e rreth 80 000 fjalëve të fjalorit të anglishtes ("Shorter Oxford Dictionary"), bërë nga Thomas Finkenstaedt-i, më 1973, dhe botuar në *Ordered profusion; studies in dictionaries and the English lexicon* (Annales Universitatis Saraviensis), ka treguar se 28,30 përqind e fjalëve të anglishtes kanë prejardhje frënge; 28,24 përqind kanë prejardhje latinë (duke përfshirë këtu edhe termat bashkëkohorë shkencorë e teknikë); 25 përqind burojnë nga Anglishtja e Mesme, norvegjishtja e vjetër dhe nga holandishtja, domethënë, kanë prejardhje gjermanike; 5,32 përqind kanë prejardhje greke; 4,03 përqind kanë etimologji të pazbërthyeshme; 3,28 përqind kanë prejardhje nga emra të përveçëm dhe 1 përqind nga të gjitha gjuhët e tjera. Pra, rreth 70 përqind e fjalëve të anglishtes janë prej brumit të huaj. Anglishtja edhe sot vazhdon të huazojë fjalë nga gjuhët e tjera, nga 120 syresh. Për këtë arsye, ajo ka leksikun më të pasur në botë, të hedhur tashmë në fjalorin e vet, me më se

¹ L. Mulaku, *Përdorimi i fjalëve angleze të panevojshme në gjuhën shqipe*, në "Studime gjuhësore", IA, Prishtinë, 2017, f. 241.

500 000 fjalë aktive dhe po kaq pasive, kur vetëm disa shekuj më parë ka pasur rreth 50.000-60.000 fjalë².

Rritja e vetëdijes gjuhësore për gjuhën shqipe

Dëmtimi i gjuhës shqipe do të ishte më i vogël me rritjen e vetëdijes gjuhësore të përdoruesve, sikur huazimet e panevojshme, sidomos anglicizmat, të mos përjashtonin fjalë, shprehje dhe ndërtime të qëndrueshme me jetë të gjatë në gjuhën shqipe. Kështu, shembujt në vijim janë vërtet shqetësues, për shkak të cektësisë së njohurive gjuhësore dhe të prirjes për t'u dukur i "kulturuar", "modern" apo "i ditur" nga ana e disave. Në vazhdim po paraqesim disa zëvendësime të panevojshme të fjalëve shqipe me ato angleze: "dypalësh" me "bilateral"; "ditëpushimi" me "holidej"; "thelbësor" me "esencial"; "shqyrtoj" me "ekzaminoj"; "i përkulshëm" me "fleksibël"; "falë, pa pagesë" me "gratis"; "rëndesë" me "gravitet"; "i papajtueshëm" me "inkompatibil"; "i pakufishëm (i pafund)" me "infinet"; "ndikim" me "influcencë"; "fytyrë" me "fejse/face"; "përrurim" me "promovim"; "sulm" me "atakim"; "kryeqytet" me "metropol"; "bërthamor" me "nuklear"; "thelbësor" me "esencial"; "cilësi" me "kualitet"; "sasi" me "kuantitet"; "bashkim" me "union"; "mirë" me "okei"; "zbatoj" me "implementoj"; "shpërndaj" me "distribuoj"; "përcaktoj" me "determinoj"; "kushte" me "kondicione"; "këmbëngulje" me "insistencë"; "tungjatjeta" me "tung" dhe "haj"; "mirupafshim" me "baj-baj" etj.


Tek nxënësit e shkollave të mesme teknike vërehet përdorimi i anglicizmave në vend termave shqip; për ilustrim po i paraqesim disa prej tyre, si: "i ashpër" me "brutal"; "urdhër" me "komandë"; "i përhershëm" me "konstant"; "largësi" me "distancë"; "paraprojekt" me "draft"; "i përpiktë" me "ekzakt"; "lojë" me "gejm"; "i lumtur" me "hepi"; "përtac" me "indolent"; "i zakonshëm" me "ordiner"; "i përkryer" me "perfekt"; "përparim" me "progres"; "nisje" me "start"; "bashkim" me "union"; "i vlefshëm" me "valid"; "përthithje" me "absorbim"; "aliazh" me "përlidhë"; "antifrizë" me "kundërngrirës"; "amortizator" me "fikatës"; "baraspeshim" me "balancim"; "baraspeshë" me "ekuilibër"; "depozitë" me "tank"; "fërkim" me "frikcion"; "gabim" me "error"; "grumbullues" me "kolektor"; "hallkë" me "link"; "kokore" me "helmet/ë"; "ndemje" me "stres"; "ndryshore" me "variabël"; "pajime" me "aksesorë"; "përsheptim" me

² A. Zeqiri, *Aspekte të huazimeve me origjinë anglo-saksone në gjuhën e folur shqipe dhe në mediat shqiptare në Maqedoni dhe Kosovë*, dis., Tiranë, 2013, f. 23.

“akselerim”; “ripërfim” me “regjenerator”; “rëndesë” me “gravitet”; “rul” me “roller”; “rrjetë” me “gridë”; “skicë” me “skeq (sketch)”; “ujëngrohës” me “boiler”; “vaj” me “ëjl-oil”; “ventil” me “valve”; “vëllim” me “volum”; “vij/ë” me “linjë/line”; “vinç” me “kran/crane”; “viz/ë” me “line”; “zgjatim” me “elongim”; “zgjerim” me “diletacion/ekspansion”; “zgjyr/ë” me “slag”; “vëllim” me “volum”; “zhvendosje” me “displasment” etj.


Rezultatet e hulumtimit

Hulumtimi në shkollën e mesme teknike “Lutfi Musiqi” në Vushtrri është bërë me gjithsej 52 nxënës. Në diagramin vijues paraqiten fjalët më të përdorshme të gjuhës angleze në vend të atyre shqipe:




Në bazë të rezultateve, nxënësit e shkollës së mesme teknike “Lutfi Musiqi”, më së shpeshti e përdorin fjalën “komandë” (shumica e nxënësve kanë kompjuter në shtëpi) dhe “hepi” për “i lumtur”, kurse më rrallë termin “absorbim” (në vend të “përthithje”).

Hulumtimi në gjimnazin “Eqrem Çabej” është bërë me gjithsej 64 nxënës. Në diagramin vijues do të paraqesim fjalët më të përdorshme të gjuhës angleze në vend të atyre shqipe.



Në bazë të rezultateve, nxënësit e gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri, më së shpeshti e përdorin fjalën *“hepi”* në vend të *“i lumtur”*, kurse më rrallë fjalën *“indolent”* për *“përtac”*.

Hulumtimi në shkollën e mesme profesionale “Bahri Haxha” është bërë me gjithsej 48 nxënës. Në diagramin vijues do të paraqesim fjalët më të përdorshme të gjuhës angleze në vend të atyre shqipe.



Në bazë të rezultateve, nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Bahri Haxha”, më së shpeshti e përdorin termin *distancë* (e kanë dëgjuar nga lënda “Vizatim teknik” dhe “Edukatë fizike”), kurse më rrallë termin “*antifriz*” në vend të termit “*kundërngrirës*”.

Përfundim

Nga hulumtimet tona, kemi arritur në përfundimin se, të shumtën e herës, shkaqet e përdorimit të anglicizmave në gjuhën shqipe nga nxënësit, në ditët tona, janë thjesht subjektive:

- përdoruesit kanë formim të mangët gjuhësor, vuajnë nga mungesa e njohurive të duhura të kulturës së gjuhës, pra, nuk kanë arritur të përvetësojnë normat gramatikore, drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore, normat leksikore dhe stilistikore. P.sh. “*finish*” për “*përfundim*”; “*benifite*” për “*përfitime*”; “*startojnë*” për “*fillojnë*”; “*selektuj*” për “*përzgjedh*”; “*nominoj*” për “*emëroj*” ose “*caktoj*”; “*akseleroj*” për “*përshejtoj*” etj.
- ata shpalosin qëndrime kozmopolite, prirje për t’u dukur të ditur dhe të mësuar, për t’u mburrur, përpara të tjerëve, ose dëshmojnë pakujdesi, mungesë përgjegjësie.

Në Republikën e Kosovës, pas shpalljes së Pavarësisë, shteti ndodhet në etapën e krijimit të institucioneve nga e para dhe përballet me shumë sfida, të cilat e largojnë vëmendjen nga hartimi i politikave të mirëfillta gjuhësore.

Me gjithë detyrën parësore të mjeteve të informimit masiv në Republikën e Kosovës, për të mbuluar të gjitha fushat e jetës në përputhje me ëndjet e rretheve të ndryshme të lexuesve, të dëgjuesve dhe të shkruesve nëpër gazeta ditore, ato i përdorin anglicizmat me shpeshtësi të njëjtë në tekste gjuhësore dhe në tekste të natyrës shkencore-teknike, në emisione të zakonshme; nuk gjejnë fjalë dhe formime shqipe, të zbërthyeshme nga pikëpamja e modeleve kuptimore dhe fjalëformuese; kanë shkëputur lidhjet me gjuhën e gjallë të popullit dhe nuk shfrytëzojnë atë, as frytet e mëhershme e të shëndosha të autorëve të shquar të gjuhës shqipe, anekënd arealit shqiptar, e, kjo vërehet edhe tek nxënësit e shkollave të mesme të larta në Komunën e Vushtrrisë; në dy shkollat e mesme teknike dhe në gjimnaz.

BIBLIOGRAFIA

Breznica, P. A., Pllana, G.F., *Analysis of phonetic, grammatical and lexical skills of English language students in the technical high*

- school "Lutfi Musiqi" in Vushtrri*, 17th International Scientific Conference THE TEACHER OF THE FUTURE 24th to 27th of May, 2018 in Budva, Montenegro International Journal KNOWLEDGE UDK 37 Scientific Papers Vol. 23.5, Skopje 2018.
- Duro, A.&Vrapi, F., *Veçori të termave me burim nga anglishtja në gjuhën shqipe*, në “Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe probleme dhe detyra”, Konferencë shkencore, ASHSH dhe ASHAK, Tiranë, 2009.
- Nuhui, V., *Ndikimet ndërghjuhësore*, Prishtinë, 1990.
- Mulaku, L., *Studime gjuhësore*, IA, Prishtinë, 2017.
- Fjalor i termave themelorë të mekanikës shqip-anglisht-frëngjisht-italisht-rusisht*, ASHSH IGJL, Tiranë, 2002.
- Shehu, H., *Studime për leksikun dhe leksikologjinë e sotme shqipe*, QSA IGJL, Tiranë, 2015.
- Thomai, J., *Ligjërata pasuniversitare (leksikologji, semantikë, leksikologji)*, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, 2015.
- Zeqiri, A., *Aspekte të huazimeve me origjinë anglo-saksone në gjuhën e folur shqipe dhe në mediat shqiptare në Maqedoni dhe Kosovë*, dis., Tiranë, 2013.

